

**OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË TREGUT**

Nr. 5977/prot.

Tiranë, më 9./12/2021

Lënda: Disa propozime nisur nga problematikat e hasura në tregun e balancimit.

**ENTIT RREGULATOR TE ENERGJISE**  
Blvd. "Bajram Curri", Rruja "Viktor Eftimi", nr. 1023, Tirane

**Inderuar Z. Ahmeti,**

Në vijim të shkresës tuaj nr.997/6 Prot, datë 09.11.2021, Ju vëmë në dijeni se, për shkak të situatës së krijuar nga kriza energjitike në gjithë Europën, e cila ka afektuar edhe Shqipërinë, janë vërejtur problematika edhe në tregun e balancimit të energjisë elektrike, që lidhen kryesisht me disbalanca të mëdha të kryera nga PPB, të cilat e tejkalojnë garancinë e depozituar nga PPB-ja përkatëse dhe si rrjedhojë rrisin mundësinë që OST të ekspozohet ndaj risqeve të mëdha financiare. Në këto kushte, për të garantuar përbushjen e detyrimeve të parashikuara në Rregullat e Balancimit dhe për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve, OST gjykon se do të ishte me vend dhe e domosdoshme edhe për shkak të rritjes së cmimeve të tregut të balancimit, reflektimin e këtyre parashikimeve në lidhje me garancinë në tregun e balancimit:

1. *OST ka të drejtën të kërkojë garanci financiare nga palët përgjegjëse për balancim. OST do të shfrytëzojë këtë të drejtë pa diskriminim dhe mbi parimin e proporcionalitetit.*
2. *Niveli i kërkuar i garancisë financiare për çdo palë përgjegjëse për balancim duhet të jetë sa ekspozimi i përgjithshëm neto i faturimeve te muajit paraardhes plus 20%. Ekspozimi mujor financiar për çdo palë përgjegjëse të balancimit llogaritet si diferenca e arkëtimeve dhe pagesave të pritshme të llogaritura. Në çdo rast vlera minimale e garancisë financiare duhet të jetë 10 milion ALL.*
3. *Për palët përgjegjëse të balancimit të posaregjistruara për të cilat nuk ka të dhëna për të llogaritur ekspozimin historik nga disbalancat, OST duhet të aplikojë vlerën fiksë për garanci financiare që është 10 milion ALL.*
4. *Kur gjatë muajit rezulton se ekspozimi financiar nga disbalancat përbën 70% të vlerës së garancisë:*
  - *OST ka të drejtë të kërkojë menjëherë përditësim e garancisë. Garancia duhet përditesuar brenda 10 ditëve kalendarike nga kërkesa e OST drejtuar PPB për përditësimim.*
  - *Përjashtimisht nga parashikimet e nenit 5.8 "Faturimi dhe Shlyerja për PPB", në cdo rast, OST do t'i kërkojë PPB të paguajë, brenda afatit të përcaktuar nga OST, vlerën e këtij ekspozimi.*

Bazuar në propozimin e mësiperë, këtu më poshtë gjeni disa llogaritje të bëra nga OST bazuar në të dhënrat faktike të disa PPB-ve:

Rasti I: Vlera minimale e llogaritur me të dhënrat faktike të deritanishme të PPB-së shembull nr 1, ka rezultuar **5,068,194** Leke (pesë milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e katër) Lekë, ndërkohë sipas propozimit të OST, ne çdo rast vlera minimale e garanciё financiare duhet të jetë 10.000.000 (dhjetë milion) Lekë.

Rasti II: Vlera maksimale e llogaritur me të dhënrat faktike të deritanishme të PPB-së shembull nr 2, ka rezultuar **156,396,805** (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesë) Lekë.

Gjithashtu, për gjithë sa më sipër, si dhe në kushtet dhe të shpalljes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, në zbatim të VKM nr. 584 date 08.10.2021, OST ka qenë e detyruar të pezullojë investimet e parashikuara për vitin 2021, duke krijuar po ashtu dhe ngadalësim të procesit të implementimit në platformën elektronike DAMAS të specifikimeve që reflektojnë përbushjen e parashikimeve të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e ERE Nr. 106, Datë, 02.07.2020. Për këto arye, OST kërkon mirëkuptimin tuaj për miratimin e zgjatjes së periudhës së parashikuar në pikën 2 të Vendimit të ERE Nr.155, datë 30.06.2021, deri në datën 30 Qershor 2022, me qellim që gjatë kësaj kohe të kryhet harmonizimi i proceseve të Tregut Balancues konform Rregullave të Balancimit si dhe të proceseve IT në varësi kjo edhe të vijimit të situatës gjatë gjëndjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike sipas VKM-se.

Mbetemi të hapur për çdo sqarim të mëtejshëm.

Duke shpresuar se propozimi ynë do të merret në konsideratë prej jush.

Me respekt,

**ADMINISTRATORI I OST SH.A.**  
  
Skerdi Drenova  
  
OPERATORI  
ISISTEMIT  
TRANSMETIMIT